



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4334 Prot.

Tiranë, më 13. 8. 2020

URDHËR

NR. 264, DATË 13. 8. 2020

PËR

**MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK  
PARAUNIVERSITAR, KOPSHTI "MEMORIAL", TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26 dhe 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti "Memorial", Tiranë, hapur me urdhrin nr. 175, datë 16.06.2005 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për funksionimin e institucionit arsimor jopublik parauniversitar:-kopshti "Memorial"", në emër të shoqërisë "UFUK, Education & Publication Company" sh.p.k.
2. Institucioni arsimor jopublik parauniversitar, kopshti "Memorial", Tiranë, ka për detyrë:
  - a) Të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka.
  - b) Të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar.
  - c) Të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.
  - d) Të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri.
  - e) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, ka për detyrë:
- Të ngrejë grup pune brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë.
  - Të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor.
  - Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik.
  - Të ruajë në arkivën e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.
5. Urdhri nr. 175, datë 16.06.2005, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial””, shfuqizohet.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë dhe Shoqëria “Turgut Ozal Education” sh.a.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

**MINISTRI**  
  
**BESA SHAHINI**

